



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI I LËNDËS

PRAKTIKË PËRKTHIMI

**Ngarkesa:** 6 kredite, 60 orë / seminare

**Viti akademik/semestri kur zhvillohet:** Viti II/semestri I

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

*Objektivat e përgjithshme lëndore:* Ky modul propozon zhvillimin e një aftësie për të përkthyer tekste pragmatike nga gjuha frënge në atë shqipe. Pra, ai synon t'i njohë studentët me elemente nocionore dhe gjuhësore të domosdoshme për të përkthyer si duhet tekstet pragmatike. Gjithashtu ai i njeh studentët me procesin e përkthimit dhe i familjarizon me mjetet e punës në përkthim

*Objektivat specifike lëndore:*

Studenti duhet:

- të sigurojë një nivel të mjaftueshëm kompetencash përkthimore që kanë të bëjnë me kuptimin, riprodhimin dhe përkthimin e teksteve pragmatike .
- të përvetësojë kërkimin për qëllime dokumentuese mbi një temë të caktuar (tema e tekstit burimor).
- të ofrojë zgjidhje për probleme të ndryshme të përkthimit duke pasur parasysh sidomos qasjen interpretative.

*Rezultate të pritshme*

- Aftësimi i studentëve për të përkthyer nga gjuha B në A, në mënyrë të pavarur dhe me cilësi, tekste me temë nga aktualiteti i përditshëm
- Përdorimi me zhdërvjelltësi i burimeve dokumentuese dhe i mjeteve teknologjike gjatë procesit përkthimor